



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:183737

Datë: 25.03.2024

Numri i dokumentit: 05497116

P.nr.8/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm Penal - gjyqtari Lulzim Hoxha, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Afërdita Kicaj, në lëndën penale kundër të akuzuarit: G. (A.) B., nga R.Shqipërisë, për shkak se ka kryer veprën penale, rrezikim i trafikut publik nga neni 370 para 8 lidhur me parag 6 dhe 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës KPRK-së, nr. 06/L-074, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP/II.nr.1595-3/21 të datës 11.01.2022, në seancën publike të shqyrtimit fillestar në prezencën e Prokurorit të Shtetit Ramadan Koro, i dëmtuari L.U., i akuzuari G. B., me mbrojtësin av. H.B., me datën 20.03.2024, mori dhe shpalli, ndërsa me datën 25.03.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

G. B., nga i ati A. dhe e ëma e lindur, i lindur mënë fshatin-Has R.Shqipërisë, tani me banim të përkohshëm rr.””në Angli, ka të kryer shkollën fillore, me profesion, punëtor, i divorcuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Shqipërisë, me numër personal të letërnjoftimit

ËSHTË FAJTOR

Me datë 17.08.2021, rrethe orës 14:25 minuta, në rrugën magjistrale Gjakovë - Prizren në fshatin Piranë, Komuna e Prizrenit, saktësisht afër pompës së derivateve “Shell”, dhe qendrës tregatë “.....”, i pandehuri G. B., duke drejtuar veturën e markës “.....” ngjyrë e zezë, me targa angleze:vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 53 të Ligjit nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor dhe me rregullat e trafikut, duke rrezikuar jetën e njerëzve si pjesëmarrës në komunikacion, në atë mënyrë që nuk e ka përshtatur shpejtësinë e lëvizjes kushteve dhe rrethanave të rrugës, ashtu që pasi ishte në një shpejtësi më të madhe se sa që është lejuar për atë rrugë hynë në tejkalimin e disa automjeteve (kolonë) dhe pas tejkalimit të disa automjeteve posa fillon tejkalimin e veturës “.....”, me targa, të cilën e voziste i pandehuri M.Sh., i cili në atë rast kishte marr vendim për tejkalim të veturave para tij dhe pasi del me një pjesë të veturës në shiritin e majtë, ngasësi i veturës “.....”, i pandehuri G. B., duke qenë në shpejtësi dhe në tejkalim godet me anën e djathtë të pjesës së përparme të automjetit në anën e majtë të automjetit “.....”, dhe si pasojë e shpejtësisë dhe goditjes së veturës “.....”, humb kontrollin dhe del jashtë cepit të majtë në kanal dhe kthehet në të djathtë dhe ndalet jashtë cepit të djathtë të drejtimit të lëvizjes, si pasojë e kësaj dy veturat e përfshira në aksident

pësojnë dëme materiale, kurse pasagjeri i cili ishte në veturën “.....”, i dëmtuari L.U., pëson lëndime të rënda trupore, si ndrydhje të indeve të buta të kafazit të kraharorit, të regjionit iJOR dhe thyerje të trupit të unazës së 2-të të regjionit iJOR të boshtit të kurrizit (lumbal,1.2), sipas akt ekspertimit mjeko ligjor të përpiluar nga eksperti mjeko-ligjor Dr. V.K., me numër referenca 02/2021 të datës 30.08.2021.

Me këto veprime ka kryer veprën penale: rrezikim i trafikut publik nga neni 370 para 8 lidhur me parag 6 dhe 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës KPRK-së, nr. 06/L-074.

Andaj, gjykata në bazë të dispozitave të lartshënuara dhe neneve 4, 7, 8, 9, 17, 38, 39, 40, 42, 43, 44, 50, 69, 70, 71,72, të KPRK-së, si dhe nenit 364 KPPRK-së,

Të akuzuarin G. B., e:

GJYKON

- Për veprën penale si në dispozitivin e këtij aktgjykimi i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve.
- Në kuptim të nenit 44 të KPK-së, me propozimin e të akuzuarit, dënimi me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumën prej **tetëqind (800,00) €**, e të cilin dënim me gjobë është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.
- Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë në mënyrën e lartcekur, atëherë mundësia e pagesës së dënimit me gjobë do të revokohet.
- Nëse i akuzuari nuk dëshiron apo nuk mundet ta paguajë dënimin me gjobë në shumë prej **tetëqind (800,00) €**, atëherë gjykata konform nenit 43 par. 3 të KPRK-së, dënimin me gjobë, do t’ia zëvendësoj me dënim me burgim, ashtu që për çdo 20 € llogaritet 1 (një) ditë burgim, gjithsej nga 40 ditë burgim.
- I dëmtuari me adresë si në shkresat e lëndës hekë dorë nga kërkesa pasurore juridike.
- OBLIGOHET i akuzuari që ti kompensoj shpenzimet e procedurës penale, sipas llogarisë përfundimtare, duke përfshirë të gjitha shpenzimet, kurse në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej njëzet (20) euro, në emër të ekspertizës mjeko ligjore shumën prej njëzet (20) euro, në emër të ekspertizës së komunikacionit rrugor shumën prej njëqind e pesëdhjetë (150,00) euro, në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej njëzet (20) euro, të gjitha këto, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit ligjor.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP/II.nr. 1595-3/21 të datës 11.01.2022, kundër të akuzuarit: G. (A.) B., nga R. Shqipërisë, për shkak se ka kryer veprën penale, rrezikim i trafikut publik nga neni 370 para 8 lidhur me parag 6 dhe 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës KPRK-së, nr. 06/L-074.

Duke vepruar në këtë çështje penale, gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar më datë 20.03.2024, në të cilin seancë me aktvendim është veçuar procedura penale ndaj të pandehurit M.Sh., për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 370 para 8 lidhur me paragraf 6 dhe 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës KPRK-së, nr. 06/L-074, i cili për gjykatën ka qenë i pa arritshëm.

I akuzuari G. B., e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës së lartcekur.

Bazuar në pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe konform dispozitave të nenit 241 e 242 të KPP-së, gjykata nuk është lëshuar në procedimin e provave.

I akuzuari deklaron se: e ka të qartë aktakuzën dhe e pranon fajësinë sipas pikave të aktakuzës. Pas konsultimit me mbrojtësin tim.

Prokurori i shtetit deklaroi se: nuk e kundërshton pranimin e fajësisë.

I dëmtuari deklaroi se: nuk e kundërshton pranimin e fajësisë. Hekë dorë nga ndjekja penale dhe nuk parashtron kërkesë pasurore-juridike.

Palët hekë dorë nga seanca mbi caktimin e dënimit.

Në shqyrtimin fillestar, gjykata, pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin të ka pranuar pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë, në këtë aspekt, i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata në shqyrtim fillestar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe provave materiale në shkresat e lëndës, ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Me datë 17.08.2021, rrethe orës 14:25 minuta, në rrugën magjistrale Gjakovë - Prizren në fshatin Piranë, Komuna e Prizrenit, saktësisht afër pompës së derivateve "Shell", dhe qendrës tregatë ".....", i pandehuri G. B., duke drejtuar veturën e markës "....." ngjyrë e zezë, me targa angleze:, vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 53 të Ligjit nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor dhe me rregullat e trafikut, duke rrezikuar jetën e njerëzve si pjesëmarrës në komunikacion, në atë mënyrë që nuk e ka përshtatur shpejtësinë e lëvizjes kushteve dhe rrethanave të rrugës, ashtu që pasi ishte në një shpejtësi më të madhe se sa që është lejuar për atë rrugë hynë në tejkalimin e disa automjeteve (kolonë) dhe pas tejkalimit të disa automjeteve posa fillon tejkalimin e veturës ".....", me targa, të cilën e voziste i pandehuri M.Sh., i cili në atë rast kishte marrë vendim për tejkalim të veturave para tij dhe pasi del me një pjesë të veturës në shiritin e majtë, ngasësi i veturës ".....", i pandehuri G. B., duke qenë në shpejtësi dhe në tejkalim godet me anën e djathtë të pjesës së përparme të automjetit në anën e majtë të automjetit ".....", dhe si pasojë e shpejtësisë dhe goditjes së veturës ".....", humb kontrollin dhe del jashtë cepit të majtë në kanal dhe kthehet në të djathtë dhe ndalet jashtë cepit të djathtë të drejtimit të lëvizjes, si pasojë e kësaj dy veturat e përfshira në aksident pësojnë dëme materiale, kurse pasagjeri i cili ishte në veturën ".....", i dëmtuari L.U., pëson lëndime të rënda trupore, si ndrydhje të indeve të buta të kafazit të kraharrorit, të regjionit i jor dhe thyerje të trupit të unazës së 2-të të regjionit i jor të boshtit të kurrizit

(lumbal,1.2), sipas akt ekspertimit mjeko ligjor të përpiluar nga eksperti mjeko-ligjor Dr. V.K., me numër referenca 02/2021 të datës 30.08.2021.

Me këto veprime ka kryer veprën penale: rrezikim i trafikut publik nga neni 370 para 8 lidhur me parag 6 dhe 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës KPRK-së, nr. 06/L-074.

Gjykata, gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë prej të akuzuarit, i cili në seancën e shqyrtimit fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, andaj gjykata nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare, gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme sipas nenit 251 të KPPK-së.

Gjithashtu, në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështetet në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Kësisoj, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 240 lidhur me neni 242, dhe se në veprimet e të akuzuarit G. B., formohen të gjitha elementet e veprës penale, rrezikim i trafikut publik nga neni 370 para 8 lidhur me parag 6 dhe 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës KPRK-së, nr. 06/L-074, dhe për këtë gjykata ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe t'i shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tij penalo-juridike.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara në nenin 69, 70, 71.72 të KPK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Prej rrethanave lehtësuese, gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pendimin për rastin e ndodhur, kërkim faljen dhe i premtoj gjykatës se nuk do të përsëris veprime të tilla kundërligjore. Ndërsa si rrethanë rënduese gjykata mori për bazë, veprën penale të kryer, niveli i dëmtimit të vlerës së mbrojtur, mënyrën e kryerjes së veprës penale, veprimi me përgjegjësi, ku i akuzuari duke drejtuar veturën e markës “.....” ngjyrë e zezë, me targa angleze:, vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 53 të Ligjit nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor dhe me rregullat e trafikut, duke rrezikuar jetën e njerëzve si pjesëmarrës në komunikacion, në atë mënyrë që nuk e ka përshtatur shpejtësinë e lëvizjes kushteve dhe rrethanave të rrugës, andaj gjykata i shqiptoi dënimin me gjobë sepse konsideron se me këtë masë sanksionuese do të arrihet qëllimi i dënimit, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla. kundërligjore

Gjykata vendimin e ka mbështetur duke u bazuar edhe në neni 38 i KPK-së i cili konsiston në *“parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij, të parandalojë personat tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcim detyrimit për respektimin e ligjit”*.

- Vendimi mbi shpenzimet e procedurës dhe paushallin gjyqësor, gjykata e mori në kuptim të nenit 449 dhe 452 para. 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-së).
- I dëmtuari me adresë si në shkresat e lëndës hekë dorë nga kërkesa pasurore juridike.

- Vendimi mbi kompensimin e viktimave të Krimit, gjykata e mori në kuptim të nenit 36 parag.3 pika 3.1 të Ligjit me numër 08/L-109. ku thuhet “*për veprën penale që gjykohet në Departamentin e Përgjithshëm të Gjykatës Themelore shuma është prej njëzet (20) Euro*”.

Nga të cekurat si më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.8/22, të datës 25.03.2024

B. Profesionale,
Afërdita Kicaj

Gjyqtari
Lulzim Hoxha

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 30 dite nga dita e pranimit të të njëjtit, ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmjet të kësaj gjykate.